



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA



AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
INSTITUTI I HISTORISË

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA	
INSTITUTI I HISTORISË - INSTITUTE OF HISTORY - INSTITUT ZA ISTORIJU	
Nr. _____ prot.	
Njësia Org. Org. Unit Org. Jed.	Nr. i prot. Prot.N. Br.Prot.
1-64	04/135/22
Prishtinë, më _____ /	Data: / 2022
No. Pages Br. Stranica	Datum: _____
04	14-10-2022
PRISHTINË - A	

Nr. 65 prot.

Tiranë më 14/10 / 2022

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Palët bien dakord për bashkëpunim të ndërsjellë:

**Neni 1**

**Palët**

Palët në këtë Marrëveshje janë: Instituti i Historisë (ASA) - Tiranë dhe Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë, përfaqësuar nga drejtorët e instituteve.

**Neni 2**

### Qëllimi dhe arsytimi

- Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që të përcaktojë fushëveprimin dhe objektivat e bashkëpunimit të palëve për realizimin e interesave të dyanshëm në fushën kërkimore dhe shkencore.
- Palët dakordohen duke detajuar qëllimin e marrëveshjes nga neni 1 dhe në pikat në vijim.
- Përfitues të këtij bashkëpunimi janë studiuesit e të dyja instituteve, palë të marrëveshjes, si dhe institucionet partnere që përfshihen në projekte e nisma të secilës palë në këtë marrëveshje.



### Neni 3

#### Fushëveprimi i bashkëpunimit të palëve

- a) Palët pajtohen që të bashkëpunojnë për hartimin e strategjisë studimore dhe kalendarit vjetor të aktiviteteve të përbashkëta kërkimore dhe shkencore.
- b) Caktimi i një koordinatori përgjegjës nga secili institut për bashkërendimin e aktivitetit kërkimor dhe shkencor.
- c) Palët do të bashkëpunojnë për organizimin dhe jetësimin e aktiviteteve shkencore, si: konferenca, simpoziume, forume debati lidhur me aspekte të ndryshme të historisë.
- d) Palët pajtohen që të kenë pjesëmarrje të ndërsjellë në këshillat botues dhe shkencorë të revistave shkencore “Kosova” dhe “Studime historike”.
- e) Palët pajtohen të zbatojnë standarde të larta botimi, mbi bazën e sistemit *peer - review* si dhe të aplikojnë kërkesat e programit antiplagjiaturë në botimet e tyre.
- f) Palët pajtohen që të realizojnë projekte të përbashkëta shkencore dhe botime të gjinive të ndryshme (monografi, vëllime me dokumente, studime me shumë autorë), diskutuar paraprakisht në departamentet dhe këshillat shkencorë përkatës, duke përfshirë studiues nga të dyja institutet në jetësimin e tyre.
- g) Palët pajtohen që të bashkëpunojnë për kualifikimin e personelit shkencor, në shkëmbimet e kërkuesve shkencorë sidomos për raste kur ata mbulojnë periudha të dokumentuara në gjuhë të vjetra/të rralla.
- h) Palët pajtohen të mbështesin promovimin e studiuesve të rinj dhe pjesëmarrjen e tyre në aktivitete midis palëve dhe me të tretët.
- i) Palët pajtohen të marrin pjesë në komisione të përbashkëta të promovimit akademik dhe të ekspertizës së thelluar.
- j) Palët pajtohen të iniciojnë, kontribuojnë dhe jetësojnë projekte madhore shkencore, përfshirë historia e Shqipërisë dhe historia e Kosovës, si dhe projekte të njëjta me rëndësi shkencore e kombëtare.
- k) Palët bien dakord të iniciojnë bashkëpunimin institucional me studiues shqiptarë e të huaj të historisë dhe të qendrave të ndryshme albanologjike.
- l) Palët pajtohen të marrin pjesë në aplikime në projekte të përbashkëta brendashqiptare dhe më gjerë, në funksion të misionit dhe objektivave studimorë.



- m) Palët pajtohen që të shkëmbejnë pa pengesë dhe falas materiale arkivore të instituteve dhe literaturë shkencore në interes të të dyja instituteve dhe studiuesve të tyre, për projekte të miratuara nga departamentet dhe këshillat shkencorë përkatës.
- n) Palët bien dakord të mbështesin administrativisht kërkuesit shkencorë për lehtësimin e procedurave për shfrytëzimin arkivor në arkivat shtetërorë të të dyja vendeve.
- o) Palët pajtohen që të shkëmbejnë të gjitha botimet e realizuara dhe të angazhohen në promovimin e tyre në hapësirat reciproke në Shqipëri dhe Kosovë.
- p) Palët pajtohen që përveç pikave të lartshënuara (a-p), të bashkëpunojnë edhe në çështje të tjera, të cilat do t'i rregullojnë me marrëveshje të veçanta përmes Këshillit Koordinues dhe miratimit zyrtar nga këshillat shkencorë.

#### **Neni 4**

#### **Autorizimet**

Palët garantojnë që bashkëpunimi të realizohet në pajtim me këtë marrëveshje.

#### **Neni 5**

#### **Mosmarrëveshjet**

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve në lidhje me këtë marrëveshje do të zgjidhet përmes negociatave ndërmjet tyre.

#### **Neni 6**

#### **Anulimi**

- a) Anulimi i kësaj marrëveshjeje mund të bëhet me vullnetin e palëve, në rast se njëra prej tyre ka dështuar ta përmbushë atë ose kërkon anulimin e njëanshëm të saj.
- b) Pala që dëshiron anulimin është e detyruar që të njoftojë palën tjetër, të paktën 1 (një) muaj përpara.



**Neni 7**  
**Kohëzgjatja**

- a) Marrëveshja miratohet paraprakisht nga institutet përkatëse.
- b) Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
- c) Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje është 4 (katër) vjet.
- d) Nëse marrëveshja nuk anulohet, ripërtërihet automatikisht çdo 4 (katër) vjet përmes aktit administrativ miratues nga institutet përkatëse.

**Neni 8**  
**Numri i kopjeve**

Kjo marrëveshje është e hartuar në 4 (katër) kopje, nga 2 (dy) për secilën palë nënshkruese.

**PALËT NËNSHKRUESE**

**Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë**

**Instituti i Historisë (ASA), Tiranë**

**Prof. as. dr. Teuta SHALA**

**Prof. dr. Afrim KRASNIQI**

**U.d. Drejtor**

*T. Shala*



**Drejtor**

*A. Krasniqi*

